

20121233008

L I G J
PËR NDRSHIMIN DHE PLOTESIMIN
E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11 dhe 53/11), pas nenit 37 shtohet neni i ri 37-a si vijon:

"Neni 37-a

Agjencia turistike e huaj që sjell turiste në Republikën e Maqedonisë, pa ndermjetesimin e agjencise turistike të vendit me licence A, ose pa marreveshje të lidhur me udherrefyesh turistike në Republikën e Maqedonisë, ka për obligim që në afat prej 24 orësh nga ora e hyrjes në Republikën së Maqedonisë, të angazhojë udherrefyesh turistike të vendit me lidhje të marreveshjes me një nga kryeresit të veprimtarisë turistike si vijojnë:

- Shoqatën e Udherrefyeshve dhe Shoqeruesve Turistike,
- agjencinë turistike me licence A,
- byrone turistike ose
- personin fizik-udherrefyesh turistike.

Për obligimin nga paragrafi 1 i këtij neni agjencia turistike e huaj informohet nga kryeresi i veprimtarisë hoteliere që menaxhon me objektin për vendosje."

Neni 2

Në nenin 60 paragrafi 1 fjalet: "me vëllim të vogël" shlyhen.

Neni 3

Në nenin 61 paragrafi 1 pas fjales "pika" numrat "1, 4 dhe 6" shlyhen.

Neni 4

Në nenin 71 paragrafi 1 pika 7, pika zëvendësohet me lidhezen "dhe" dhe shtohet pike e re 8, si vijon:

"8) Agjencia turistike e huaj që sjell turiste në Republikën e Maqedonisë, pa ndermjetesimin e agjencise turistike të vendit me licence A, ose pa marreveshje të lidhur me udherrefyesh turistike në Republikën e Maqedonisë, nuk vepron në pajtim me nenin 39 paragrafi 2 të këtij ligji."

Në paragrafin 2 pas numrit "1" shtohen fjalet: "pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7".

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

"Gjohet në shumë prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denare do t'i kumtohet aty për aty personit përgjegjës të agjencise turistike të huaj, për grupin e organizuar të turistëve, për veprimin nga paragrafi 1 pika 8 të këtij neni."

Paragrafet 3 dhe 4 behen paragrafe 4 dhe 5.

Neni 5

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvenës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të percaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".